



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

*Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe Teknologjisë- Ministarstva za Obrazovanje Nauku i
Tehnologiju-Ministry of Education Science & Technology*

Kabineti i Ministrit/Kabinet Ministra/ Cabinet of the Minister

NUMËR: 10 /2009

DATA: 27.05.2009

UDHËZIM ADMINISTRATIV

Kushtet dhe kriteret për vlerësimin e shkallës së arritshmërisë së nxënësve dhe kandidatëve të rritur me nevoja të veçanta

Në mbështetje të nenit 93 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe në bazë të nenit 5.5 të Ligjit për provimin përfundimtar dhe provimin e maturës shtetërore, si dhe neneve 2.1, 15.1,35,36,37 të Ligjit mbi arsimin fillor dhe të mesëm në Kosovë, dhe nenit 25, paragrafi 7 të Rregullores së Punës të Qeverisë së Kosovës nr. 1/2007, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë nxjerr këtë Udhëzim administrativ:

Neni 1
Qëllimi

Me anë të këtij Udhëzimi administrativ caktohet mënyra e organizimit, përmbajtja, kushtet, kriteret dhe procedurat e provimit përfundimtar dhe provimit të maturës shtetërore për nxënësit dhe kandidatët e rritur me nevoja të veçanta.

Neni 2
Nacionet

- 1.** Kandidat me nevoja të veçanta cilësohet ai kandidat që ka zhvillim të ngadalësuar psiko-fizik dhe mental, i cili dukshëm kufizon një apo më shumë aktivitete.
 - 1.1.** Dëmtime në të dëgjuar, u referohet të gjithë kandidatëve që kanë shkallë të humbjes së të dëgjuarit, nga të lehtat deri te më të rëndat.
 - 1.2.** Dëmtime në të parë, u referohet të gjithë kandidatëve që kanë dëmtime në të parë duke filluar nga ato më të lehtat e deri tek ato më të rëndat.

1.3. Dëmtime intelektuale, u referohet të gjithë kandidatëve që kanë shkallë të dëmtimeve mentale-psikologjike të individit shkallë intelektuale, e cila është nën nivelin e shkallës së pritur për moshën e individit.

1.4. Dëmtime fizike, u referohet të gjithë atyre që kanë dëmtime të lindura apo të fituara gjatë jetës si dëmtime të muskujve që shkaktojnë vështirësi, kufizime dhe pamundësi të lëvizjes së lirë dhe të kryerjes së aktiviteteve të jetës së përditshme.

Neni 3

Organizimi dhe përmbajtja e provimit përfundimtar dhe provimit të maturës shtetërore

1. Provimi përfundimtar mbahet në pjesën teorike dhe praktike varësisht nga profilet-drejtimet e caktuara që kandidatët i kanë vijuar.
2. Provimi i maturës mbahet me test të standardizuar.

Neni 4

Përmbajtja e provimit të maturës

1. Provimi i maturës përbëhet nga:
 - 1.1 Lëndët e përgjithshme të cilat janë: gjuhë amtare, gjuhë angleze dhe matematikë;
 - 1.2 Lëndët zgjedhore të përcaktuara varësisht nga tipi i gjimnazit apo shkollës profesionale;
 - 1.3. Modeli i testit për vlerësimin e provimit të maturës, do të përgatitet nga Qendra e Vlerësimit.

Neni 5

Procedurat e vlerësimit të provimit përfundimtar

1. Provimit përfundimtar nxënësit dhe kandidatët e rritur me nevoja të veçanta, i nënshtrohen në kushte dhe kritere jo të njëjta (të veçanta) përshtatur nevojave të tyre sipas profilit të caktuar arsimor.
2. Në provimin përfundimtar që realizohet në mbarim të arsimit të mesëm të lartë -niveli i tretë (kl. XII -të, XIII-të) në shkollat profesionale të nxënësit dhe kandidatët e rritur me nevoja të veçanta duhen vlerësuar veçanërisht shkathtësitë e tyre profesionale që posedon kjo kategori e nxënësve në varësi prej profilit të caktuar arsimor.
3. Kandidati (nxënësi) i cili jashtë Kosovës ka marrë një dëftesë të barasvlershme me dëftesën e mbarimit të shkollës së mesme të lartë në Kosovë, e cila është e verifikuar, ka të drejtë të hyjë në provimin përfundimtar.
4. Kandidati i kthyer i nënshtrohet provimit aty ku e cakton MASHT-i, bazuar në dokumentin e verifikuar për drejtimin përkatës në bashkëpunim me DKA.

Neni 6

Procedurat e vlerësimit të provimit të maturës shtetërore

1. Provimit të maturës nxënësit dhe kandidatët e rritur me nevoja të veçanta, i nënshtrohen në kushte dhe kriteret jo të njëjta (të veçanta) përshtatur nevojave të tyre por, në të njëjtën kohë si edhe kandidatët tjerë.
2. Nxënësi dhe kandidati i rritur me nevoja të veçanta i cili jashtë Kosovës ka marrë një dëftesë të barasvlershme me dëftesën e mbarimit të shkollës së mesme të lartë në Kosovë, e cila është e nostrifikuar (verifikuar), ka të drejtë të hyjë në provimin e maturës shtetërore.
3. Kandidati i kthyer i nënshtrohet provimit aty ku e cakton MASHT-i, bazuar në dokumentin e verifikuar për drejtimin përkatës në bashkëpunim me DKA.

Neni 7

Kriteret e provimit të maturës të kandidatëve dhe të rriturve me nevoja të veçanta

1. Për nxënësit dhe kandidatët e rritur me nevoja të veçanta që i nënshtrohen provimit të maturës kriteri i kalueshmërisë caktohet me vendim të posaçëm nga Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë nga rezultati i përgjithshëm i arritshmërisë së pikëve të provimit të maturës.
2. Kandidati, i cili e arrin kriterin e kalueshmërisë sipas paragrafit 1 të këtij neni, shpallet i diplomuar i shkollës së mesme të lartë dhe arrin kushtin e përgjithshëm për të vazhduar shkollimin e mëtutjeshëm.
3. Kandidati, i cili nuk e arrin rezultatin e kalueshmërisë sipas paragrafit 1 të këtij neni shpallet përsëritës i provimit të maturës.

Neni 8

Afati i organizimit të provimit përfundimtar dhe provimit të maturës shtetërore

1. Provimi përfundimtar organizohet në fund të vitit mësimor para provimit të maturës, ndërsa nxënësit dhe kandidatit të rritur me nevoja të veçanta i cili nuk ka kryer provimin përfundimtar nuk i lejohe të hyjë në provimin e maturës.
2. Provimi i maturës organizohet në dy afate të rregullta: në afatin e qershorit dhe gushtit.
3. Data e mbajtjes së provimit të maturës, caktohet nga Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe ajo bëhet publike.
4. Kandidati (me nevoja të veçanta), i cili nuk arrin kriterin e kalueshmërisë të provimit të maturës në afatet e rregullta dhe atyre të caktuara me vendim të MASHT-it, i nënshtrohet provimit të maturës në vitin vijues shkollor.

Neni 9

Kategorizimi dhe kushtet e mbajtjes së provimit të maturës për nxënësit dhe kandidatët e rritur me nevoja të veçanta me probleme në të dëgjuar

1. Për nxënësit që kanë probleme në të dëgjuar duhet të plotësohen këto kushte:
2. Të sigurohen klasa (hapësira) të përshtatshme për këtë kategori të nxënësve dhe kandidatëve për mbarëvajtjen e provimit të maturës.

3. Të sigurohen teste me lëndë dhe me përmbajtje sipas profilit/drejtimit të caktuar. (të njëjta apo specifike varësisht prej kushteve dhe rrethanave ekzistuese).
4. Administruesi të jetë interpretues i gjuhës së shenjave.
5. Administruesi nxënësve/kandidatëve me nevoja të veçanta t'u ndihmojë në anën teknike e assesi të mos i ndihmojë për zgjidhjen e kërkesave.
6. Të caktohet për secilin nxënës - kandidat nga një administrues (interpretues i shenjave) në klasë.

Neni 10

Kategorizimi dhe kushtet e mbajtjes së provimit të maturës për nxënësit dhe kandidatët e rritur me nevoja të veçanta me probleme me të pamurit

1. Për nxënësit që kanë probleme me të pamur duhet të plotësohen këto kushte:

- 1.1. Të sigurohen klasa (hapësira) të përshtatshme për këtë kategori të nxënësve dhe kandidatëve për mbarëvajtjen e provimit të maturës.
- 1.2. Mundësisht të sigurohen teste të përpiluara me alfabet të Brail-it (varësisht prej kushteve dhe rrethanave ekzistuese).
- 1.3. Në bazë të kërkesave të kandidatëve të sigurohet tekst me fond më të madh të shkronjave për nxënësit dhe kandidatët me nevoja të veçanta me të pamur të dobët.
- 1.4. Administruesi nxënësve/kandidatëve me nevoja të veçanta t'u ndihmojë në anën teknike e assesi të mos i ndihmojë për zgjidhjen e kërkesave.
- 1.5. Të caktohet për secilin nxënës - kandidat nga një administrues në klasë.
- 1.6. Administruesi aty ku është e domosdoshme (për nxënësit dhe kandidatët me nevoja të veçanta me verbim total) t'ia lexojë tekstin dhe t'i ndihmojë në bartjen e përgjigjeve në fletëpërgjigje.

Neni 11

Kategorizimi dhe kushtet e mbajtjes së provimit të maturës për nxënësit dhe kandidatët e rritur me nevoja të veçanta me probleme mentale

1 Për nxënësit që kanë probleme mentale duhet të plotësohen këto kushte:

- 1.1. Të sigurohen klasa (hapësira) të përshtatshme për këtë kategori të nxënësve dhe kandidatëve për mbarëvajtjen e provimit të maturës.
- 1.2. Administruesi nxënësve/kandidatëve me nevoja të veçanta t'u ndihmojë në anën teknike e assesi të mos i ndihmojë për zgjidhjen e kërkesave.
- 1.3 . Të caktohet për secilin nxënës - kandidat nga një administrues në klasë.

Neni 12

Kategorizimi dhe kushtet e mbajtjes së provimit të maturës për nxënësit dhe kandidatët që kanë të meta fizike trupore

1. Për nxënësit që kanë të meta fizike trupore duhet të plotësohen këto kushte:

- 1.1. Të sigurohen klasa (hapësira) të përshtatshme për këtë kategori të nxënësve dhe kandidatëve për mbarëvajtjen e provimit të maturës.
- 1.2. Administruesi nxënësve/kandidatëve me nevoja të veçanta t'u ndihmojë në anën teknike

e assesi të mos i ndihmojë për zgjidhjen e kërkesave.

1.3. Të caktohet për secilin nxënës - kandidat nga një administrues në klasë.

Neni 13

Administruesit e testeve për nxënësit me nevoja të veçanta

1. Administruesit caktohen nga Drejtoria Komunale e Arsimit me kritere të cilat u përshtaten nevojave të nxënësve dhe kandidatëve të rritur me nevoja të veçanta, ndërsa caktimi i tyre në paralele bëhet nga kryetarët e Komisioneve në qendra të testimit.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë tjera të administruesve dhe vëzhguesve përcaktohen me udhëzim administrativ për administrues dhe vëzhgues.

Neni 14

Vërtetimi i identitetit të kandidatëve me nevoja të veçanta

Vërtetimi i identitetit të kandidatëve gjatë hyrjes në provimin përfundimtar ose të maturës bëhet përmes dokumenteve zyrtare të identifikimit.

Neni 15

Kohëzgjatja e provimit

Provimi i maturës do të zgjasë (dyqinddhjetë) 210 minuta.

Neni 16

E drejta në ankesë

1. Të drejtë ankesë kanë të gjithë kandidatët të cilët nuk janë të kënaqur me procesin e verifikimit dhe vlerësimit të tyre.
2. Afati për ankesë është (tri) 3 ditë pas publikimit të rezultatit.

Neni 17


Dispozitat shfuqizuese

Më hyrjen në fuqi të këtij U.A. shfuqizohen të gjitha dispozitat nënligjore të cilat janë në kundërshtim më këtë U.A.

Neni 18

Hyrja në fuqi

Ky U.A. hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.



Enver Hoxhaj, ministër